



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



PROCESVERBAL

i mbledhjes së -II- (dytëe) të jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja u mbajt me datë: 30.06.2025 dhe filloi në ora: 9:55.

Në mbledhje morë pjesë: Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi, drejtori për Ekonomi, Financa dhe Buxhet Blerim Thaçi, anëtarët e komisionit: Veton Zogaj, Sadik Vrenezi, Gentianë Hoti, Rukije Bytyqi, dhe zyra për informim.

Mungon: Hamit Lima (LDK).

Argjend Thaçi: Përshëndetje për të gjithë dhe mirë se keni ardhur!

Hapi mbledhjen e -II- (dytë) të jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kush është për këtë rend të ditës?

Me vota unanime, Kryesuesi konstatoi se u miratua ky:

Rend i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitin 2026-2028, e theks të veçantë për vitin 2026.
2. Të ndryshme.

Pika e parë

Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitin 2026-2028.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Drejtorja për Ekonomi dhe Financa e ka përgadit Kornizën afatmesme buxhetore. Drejtori është prezent dhe na informon më hollsisht.

Blerim Thaçi (Drejtor për Buxhet dhe Financa): Është obligim ligjor që KAB 1 të kalon deri me datë: 30.06.2025 në asamble. Buxheti është bërë në bazë të regjistrimit të popullsisë që është bërë në Kosovë, gjë që ka ndikuar dhe në uljen e buxhetit për vitin 2026. Faktikisht në numra nuk ka as ulje as ngritje, sepse atë pjesën që është zvogluar e kanë rrit tavanin e të hyrave vetanake gjë që e balanson buxhetin e vitit të ardhshëm. Totali i buxhetit është: 22,088,7100.00E,

i ndarë në 5 kategori: paga dhe medijtje 13,145,020.48E, mallra dhe shërbime 2,555,812.00E, komunal 500,000.00E, subvensione dhe transfere 600,000.00E, investime kapitale 5,287,877.52 E.

Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit): Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Tek faqja 6, te pagat dhe shtesat zyra e kryetarit është shuma e njejtë nga viti 2025 deri në vitin 2028, nuk ka lëvizje.

Te Bujqësia kemi një rënie në vitin 2025 janë 163,083.00E ndërsa në vitin 2026 janë 134,892.00E. Pse është paraparë kjo rënie.

Te buxheti aktual 2025 dhe kufijt buxhetor për periudhën 2026-2028-Te të hyrat vetanake është paraparë një trend i rritjes.

Shërbimet rezidenciale për çka bëhet fjalë sepse ka një rritje?

Te planifikimi i të hyrave vetanake komunale 2026-2028 ka trend të rritjes.

Tek tatimi në tokë, a ka filluar komuna me inkasu taksa për tatim për tokën bujqësore dhe a janë duke bërë pagesat fermerët. Te licencat dhe lejet ka një rënie. A bëhet fjalë dhe për lejet ndërtimore, sepse ka një trend të rritjes së ndërtimit dhe këtu parashihet një rënie tek kjo kategori.

Taksa për ushtrimin e veprimtarisë në vitin 2025 janë zero ndërsa në vitet tjera ka një ngritje.

Qiraja për objektet publike në vitin 2025 janë zero. Sa objekte janë publike që janë me qira?

Blerim Thaçi (Drejtor për Buxhet dhe Financa): Tek qiraja është dhe qështja e pishinës së Banjës. Këtë vit është dhënë në shfrytëzim për një vit, është e drejta e Gjeodezisë që i jep në shfrytëzim për një vit. Te licenca dhe lejet nuk është vetëm për leje ndërtimore por dhe leje tjera. Tatimi në pronë, vitin e kaluar dhe këtë vit kanë nisur të bëhet pagesa e pronave bujqësore, shumica e tyre që e kanë në emër të vetë dhe nuk kanë telashe e pronësi. Te shërbimet rezidenciale është një kategori që e ka ndarë për personat me aftësi të kufizuar që kryhen shërbime për ta. Te drejtorja për bujqësi subvencionet i kemi planifikuar për vitin 2026 në vlerë 600,000.00E, këtë vit e kemi më të ulët sepse jemi të ngarkuar tek shërbimet e varrimit. Jo vetëm tek zyra e kryetarit, por te çdo punëtor është ruajtur ajo e vitit 2025. Kjo e vitit 2025 në vlerë 84,720.00E ka qenë ngritja e pagave nga 55E. Rritja e nrit fizik të puntorëve është lejuar për 10 punëtor, 6 na kanë lejuar në programin parafillor dhe katër na kanë lejuar në shëndetësi për këtë arsye është rritur pak vlera e kategorisë së pagave.

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Stafi dhe politika të reja çka është?

Blerim Thaçi (Drejtor për Buxhet dhe Financa): Kjo është kategoria për rritjen e numrit fizik të punëtorëve.

Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit): Ne në regjistrim të popullsisë kemi rënie dhe përderisa është zvogëluar buxheti pse nuk është ulur dhe numri i punëtorëve.

Blerim Thaçi (Drejtor për Buxhet dhe Financa): Ne si komunë gjithmonë kemi bërë kërkesë për rritjen e numrit të punëtorëve. Në këtë rast vetëm asambleja është prekur që është zvogëluar për 4 asambleistë

Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit): Kush është për miratimin e Komizës Afatmesme Buxhetore për vitin 2026-2028, e theks të veçantë për vitin 2026?


Me vota unani, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Këtë mbledhje e shpalli të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në ora:10:20.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina



Kryesuesi i Kuvendit

Argjend Thaçi

